

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **KOMUNA E VUSHTRRIË**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **2026/644-26-4808-1-2-1/B05-0012190**

Sa i përket tenderit për: **Digjitalizimi i sistemit te salles se kuvendit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

SMART MODEL LLC

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

KALABRI

(Adresa)

Prishtinë

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

+ 383 (0) 49-19 21 48

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Zymer Veliu

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Smartmodel.rks@gmail.com

(Adresa elektronike)

27.08.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” apo “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. 18.06.2026 Njoftimi për Kontratë është publikuar në e-prokurim
2. 08.07.2026 Afati i fundit për dorzim në ora 10:00
3. 19.06.2026 B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara
4. 22.06.2026 Kërkesë për rishqyrtim
5. 22.06.2026 Vendimi Refuzues i AK
6. 25.06.2026 13:42 Ankesa OSHP_finale (1)
7. 06.08.2026 13:18 Vendimi_2026 0423.
8. 17.08.2026 08:30 Kërkesë për rishqyrtim.
9. 17.08.2026 Vendimi Refuzues i pasafatshëm
10. Afati i fundit për dorëzim është: 17.08.2026 në 14:00:00
11. 17.08.2026 Procesverbali i hapjes

12. 19.08.2026 B-58-034 Njoftimi mbi Vendimin e AK.

13. 19.08.2026 13:04 Kerkes per qasje ne dokumenta

14. 19.08.2026 Vendimi i AK për lejin e qasjes

15. 24.08.2026 Vendimi ne kerkesen per rishqyrtim nga AK-ja

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	☐				Jo	☒	
----	--------------------------	--	--	--	----	-------------------------------------	--

Procesverbali i hapjes është pranuar përmes platformës së e-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	☒				Jo	☐	
----	-------------------------------------	--	--	--	----	--------------------------	--

Lënda: Ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Digjitalizimi i sistemit të sallës së kuvendit”, Kodi i procedurës: 2026/644-26-4808-1-2-1/B05-0012190

Ankues:

SMART MODEL LLC, Prishtinë

Kundër:

Komuna e Vushtrrisë – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik

Operatori Ekonomik SMART MODEL LLC paraqet këtë ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 24.08.2026, me të cilin është refuzuar kërkesa për rishqyrtim lidhur me kriteret e dosjes së tenderit për aktivitetin e prokurimit “Digjitalizimi i sistemit të sallës së kuvendit”.

Vlerësojmë se kriteret e kontestuar janë në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (i ndryshuar dhe

plotësuar), veçanërisht me parimet e proporcionalitetit, konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Ankesa mbështetet, ndër të tjera, në:

- Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar;
- Nenin 1 – Qëllimi i Ligjit;
- Nenin 4 – përkufizimet dhe konceptin e palës së interesuar;
- Nenin 7 – Barazia në Trajtim, Mosdiskriminimi dhe Transparenca;
- Nenin 28 – kërkesat dhe rregullat lidhur me dokumentet dhe specifikimet e tenderit;
- Nenin 46 – rregullat lidhur me konkurrencën;
- Nenin 56 – vlerësimin e tenderëve;
- Nenin 65 – kriteret e përzgjedhjes dhe pranueshmërisë;
- Nenin 69 – kapacitetin teknik dhe profesional;
- Nenin 108/A – zgjidhjen preliminare të mosmarrëveshjeve;
- Nenin 109 – të drejtën për ankesë pranë OSHP-së;
- Nenin 111 – përmbajtjen dhe bazat e ankesës;
- nenet përkatëse që rregullojnë kompetencat e OSHP-së dhe shqyrtimin e pretendimeve;
- Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, përfshirë dispozitat lidhur me sigurimin e tenderit dhe procedurat e shqyrtimit.

Neni 109 i LPP-së parashikon shprehimisht të drejtën për ankesë kundër vendimit të AK-së në procedurën paraprake dhe afatin prej dhjetë (10) ditësh për paraqitjen e saj.

Ndërsa Rregullorja Nr. 001/2022 përcakton se sigurimi i tenderit, kur kërkohet nga AK-ja, duhet të respektohet sipas kushteve të DT-së dhe se mosdorëzimi brenda afatit sjell refuzimin e tenderit.

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te pa kënaqur me përgjigjen e dhënë nga AK-ja në kërkesen për rishqyrtim të datës 21.08.2026 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues- **Komuna e Vushtrrisë** në lidhje me aktivitetin e prokurimit: **“Digjitalizimi i sistemit të sallës së kuvendit”** në afatin ligjor konform nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, ushtrojmë këtë:

ANKESË

Për shkak se **AK- Komuna e Vushtrrisë** në përgjigjen e dhënë në kërkesen për rishqyrtim të dhënë vlerësojmë se kriteret e kontestuar janë në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (i ndryshuar dhe plotësuar), veçanërisht me parimet e proporcionalitetit, konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë.

OBJEKTI I ANKESËS

SMART MODEL L.L.C., në cilësinë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e lartcekur të prokurimit, paraqet këtë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues nr. 640/26, datë 24.08.2026, me të cilin është refuzuar kërkesa jonë për rishqyrtim.

Objekt i kësaj ankese është ligjshmëria e vendimit të kundërshtuar, ligjshmëria e procesit të vlerësimit dhe dhënies së kontratës, si dhe nevoja për verifikimin e rrethanave konkrete që lidhen me:

- trajtimin e kërkesës për rishqyrtim;
- të drejtën e SMART MODEL L.L.C. për shqyrtim efektiv të pretendimeve;
- dokumentacionin dhe ofertën e grupit të shpallur fitues;
- MAF-et dhe autorizimet e kërkuara për produktet e ofruara;
- dokumentacionin teknik të produkteve;
- sigurimin e tenderit;
- kronologjinë e publikimit dhe ndryshimit të Dosjes së Tenderit;
- regjistrimin paraprak të projektit të prodhuesi VISSONIC;

- mundësinë e ekzistimit të një avantazhi paraprak për grupin e shpallur fitues;
- si dhe efektin e kërkesave kumulative për staf, certifikime dhe ISO në konkurrencën reale.

Kjo ankesë nuk paraqitet me qëllim të pengimit të procedurës dhe as vetëm për shkak se SMART MODEL L.L.C. nuk është shpallur fitues.

Sipas informacioneve dhe dokumenteve që kemi në dispozicion, ekzistojnë gjithashtu rrethana objektive që kërkojnë verifikim të thelluar lidhur me mundësinë e ekzistimit të një avantazhi paraprak të grupit të shpallur fitues dhe me mënyrën se si janë hartuar dhe zbatuar kërkesat e tenderit.

SMART MODEL L.L.C. kërkon që faktet konkrete të verifikohen dhe që ligjshmëria e procedurës të shqyrtohet sipas standardit të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë.

BAZA LIGJORE

Kjo ankesë mbështetet në dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar, përfshirë, sipas zbatueshmërisë së tyre:

- Nenin 1 – Qëllimi i Ligjit;
- Nenin 4 – përkufizimet dhe konceptin e palës së interesuar;
- Nenin 7 – Barazia në Trajtim, Mosdiskriminimi dhe Transparenca;
- Nenin 28 – kërkesat dhe rregullat lidhur me dokumentet dhe specifikimet e tenderit;
- Nenin 46 – rregullat lidhur me konkurrencën;
- Nenin 56 – vlerësimin e tenderëve;
- Nenin 65 – kriteret e përzgjedhjes dhe pranueshmërisë;
- Nenin 69 – kapacitetin teknik dhe profesional;
- Nenin 108/A – zgjidhjen preliminare të mosmarrëveshjeve;
- Nenin 109 – të drejtën për ankesë pranë OSHP-së;
- Nenin 111 – përmbajtjen dhe bazat e ankesës;
- dispozitat përkatëse të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik;
- si dhe dispozitat përkatëse të Udhëzuesit për Prokurimin Publik.

SHKELJET E PRETENDUARA

Ankuesi pretendon se Vendimi nr. 640/26 është i paligjshëm dhe nuk i është përgjigjur në mënyrë substanciale pretendimeve konkrete të ngritura në kërkesën për rishqyrtim.

Në veçanti, pretendojmë:

1. Shkelje të së drejtës së palës së interesuar për shqyrtim efektiv të pretendimeve;
2. Mungesë të arsyetimit konkret dhe individual për pretendimet e paraqitura;
3. Interpretim të gabuar të konceptit të interesit material dhe juridik;
4. Përdorim të zgjeruar dhe të pasaktë të konceptit të “res judicata” për të shmangur shqyrtimin e fakteve të reja;
5. Mosshqyrtim të provave dhe rrethanave lidhur me MAF-in dhe regjistrimin paraprak të projektit;
6. Mosverifikim të plotë të dokumentacionit të grupit të shpallur fitues;
7. Mosverifikim individual të MAF-it ose autorizimit për produktet për të cilat kjo kërkesë ishte vendosur në Dosjen e Tenderit;
8. Mosverifikim të dokumentacionit teknik për pozicionin nr. 15;
9. Mosverifikim të vlefshmërisë dhe shtrirjes juridike të sigurimit të tenderit të grupit fitues;
10. Mosshqyrtim të ndikimit të kërkesave kumulative për staf, certifikime dhe ISO në konkurrencën reale;
11. Mosshqyrtim të rrethanave objektive që krijojnë dyshim për ekzistimin e një avantazhi paraprak;
12. Shkelje të parimeve të konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë, transparencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit.

VENDIMI I AK-së NUK U ËSHTË PËRGJIGJUR PRETENDIMEVE KONKRETE TË ANKUESIT
 Pretendimi kryesor i Ankuesit është se AK-ja nuk e ka kryer shqyrtimin substancial të çështjeve konkrete të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim..

Në vend që të analizojë një për një pretendimet për:

- MAF-in e grupit fitues;
- produktet për të cilat nuk është paraqitur MAF;
- mungesën e dokumentacionit teknik;
- regjistrimin paraprak të projektit të VISSONIC;
- avantazhin që mund të ketë krijuar ky regjistrim;
- kriteret e stafit;
- kombinimin e certifikimeve;
- ISO-të;
- sigurimin e tenderit të grupit fitues;

- dhe ndikimin e këtyre elementeve në konkurrencë.

Në vend që këto pretendime të shqyrtoheshin individualisht dhe në substancë, AK-ja e ka përqendruar vendimin në statusin e ofertës së Ankuesit.

Ky arsyetim nuk i përgjigjet pyetjes kryesore:

A janë respektuar nga grupi i shpallur fitues të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe a është zhvilluar procedura në kushte të konkurrencës reale dhe të barabartë?

Kjo pyetje është e pavarur nga fakti nëse oferta e Ankuesit ka qenë apo jo e përgjegjshme.

Kjo pyetje kërkon shqyrtim të veçantë dhe nuk mund të shmanget vetëm duke iu referuar statusit të ofertës së Ankuesit.

PRETENDIMI I AK-së PËR “MUNGESË TË INTERESIT MATERIAL DHE JURIDIK” DUHET TË SHQYRTOHET NGA OSHP

AK-ja pretendon se Ankuesi nuk ka interes material dhe juridik sepse oferta e tij është shpallur e papërgjegjshme.

Ky përfundim është i kundërshtueshëm.

Neni 108/A i LPP-së parashikon mekanizmin e kërkesës për rishqyrtim për palën e interesuar e cila pretendon se është dëmtuar ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar. OSHP-ja vetë e përshkruan këtë si mekanizëm që mund të lidhet me vendimet e AK-së gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit.

Edhe neni 109 i LPP-së parashikon se kundër vendimit të AK-së në procedurën paraprake mund të paraqitet ankesë pranë OSHP-së dhe se afati për këtë ankesë është dhjetë (10) ditë nga vendimi i AK-së.

Në këtë rast, Ankuesi nuk po kërkon thjesht që t'i jepet kontrata.

Ankuesi po pretendon se:

procedura në tërësi është zhvilluar në rrethana që mund të kenë cenuar konkurrencën dhe trajtimin e barabartë.

Nëse një operator ekonomik është penguar nga kushte të tenderit ose nga një mekanizëm i MAF-it për të konkurruar në kushte të barabarta, fakti që oferta e tij është konsideruar e papërgjegjshme nuk duhet të përdoret automatikisht si arsye për të shmangur shqyrtimin e pretendimeve për ligjshmërinë e procedurës.

Pikërisht për këtë arsye kërkojmë që OSHP-ja ta shqyrtojë këtë çështje në mënyrë substanciale.

“RES JUDICATA” NUK MUND TË PËRDORET PËR TË PËRJASHTUAR SHQYRTIMIN E

FAKTEVE DHE RRETHANAVE TË REJA

AK-ja pretendon se pretendimet tona janë “çështje e gjykuar” për shkak të Vendimit të OSHP-së nr. 2026-0423.

Ky përfundim është tepër i gjerë.

Ankuesi nuk po kërkon nga OSHP-ja të rihapë thjesht çështjen e vendosur me Vendimin 2026-0423.

Pretendimet aktuale lidhen edhe me:

vendimin përfundimtar për dhënien e kontratës;

dokumentet e dorëzuara nga grupi fitues;

MAF-et e dorëzuara nga grupi fitues;

produktet konkrete të ofruara;

dokumentacionin teknik të ofertës fituese;

sigurimin e tenderit;

rrethanat e regjistrimit paraprak të projektit;

komunikimin me prodhuesin VISSONIC;

dhe përputhjen ndërmjet informacionit të marrë para përfundimit të procedurës dhe identitetit të grupit të shpallur fitues.

Këto janë rrethana që lidhen drejtpërdrejt me fazën e vlerësimit dhe dhënies së kontratës.

Prandaj nuk mund të trajtohen në mënyrë automatike si “çështje e gjykuar”.

Edhe vetë KRPP ka sqaruar se procedura e rishikimit lidhet me aktivitetet dhe lëshimet e AK-së gjatë fazave të ndryshme të aktivitetit të prokurimit.

RRETHANAT QË KRIJOJNË DYSHIM SERIOZ PËR AVANTAZH PARAPRAK

Kjo është çështja më serioze e kësaj ankese.

Ankuesi nuk po kërkon që OSHP-ja të shpallë si fakt të provuar se tenderi është “i trukuar”.

Por kërkon që OSHP-ja të konstatojë se ekzistojnë **rrethana objektive dhe të dokumentueshme që kërkojnë hetim dhe verifikim të pavarur.**

Këto rrethana janë:

1. Ankuesi e kishte ngritur shqetësimin përpara përfundimit të procedurës

Më 25.06.2026, para përfundimit të procedurës, Ankuesi kishte evidentuar në mënyrë të koduar informacionin e marrë lidhur me projektin dhe operatorët që dyshohej se kishin siguruar paraprakisht mbrojtje të projektit dhe qasje në MAF.

Në Ankesën e datës 25.06.2026 para hapjes së tenderit kjo është dokumentuar në formë të koduar me formulimin:

"I....T&C...@E.....C"

Kjo mënyrë e shënimit nuk ka qenë rastësore. Në atë fazë nuk kishim në dispozicion të gjitha dokumentet dhe provat që kemi sot dhe nuk kemi dashur të bëjmë një akuzë të drejtpërdrejtë pa pasur mundësi ta dokumentojmë plotësisht. Megjithatë, e kemi evidentuar që atëherë informatën që kishim marrë nga prodhuesi.

Fakti se kjo është bërë më 25.06.2026, përpara shpalljes së rezultatit përfundimtar, është i rëndësishëm për vlerësimin e besueshmërisë së këtij pretendimi. OSHP e ka regjistruar pikërisht këtë datë si datën kur është pranuar ankesa e OE-së në këtë aktivitet të prokurimit dhe ka konstatuar se ankesa ishte paraqitur në përputhje me kërkesat e nenit 111 të LPP-së, pas procedurës paraprake sipas nenit 108/A.

Sot, pas shpalljes së rezultatit dhe pasi kemi në dispozicion dokumentacionin e grupit të shpallur fitues, kjo rrethanë e shënuar atëherë në mënyrë të koduar merr një rëndësi shumë më të madhe dhe kërkon verifikim objektiv.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.
- I....T&C...@E.....C

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.

***Kjo figur është marr nga Ankesa e datës 25.06.2026 ku është shënuar në mënyrë të koduar se cilit OE i është
pergaditur dosja e tenderit që të fitoj***

Kjo rrethanë është e rëndësishme sepse shqetësimi nuk është krijuar pasi u shpall fituesi.

Ai është dokumentuar para përfundimit të procedurës.

2. VISSONIC ka konfirmuar regjistrimin paraprak të projektit

Në komunikimin me përfaqësuesin e VISSONIC është deklaruar:

"...when they come to us with project information in advance than others, we will check and make it registered to protect them..."

dhe:

“Very sorry that the project you mentioned in this email was registered by another company who asked for offer and MAF 5 days ago.”

Sipas këtij komunikimi, kompania IMPACT&CIMI@ELECTRONIC kishte kërkuar ofertë dhe MAF pesë ditë para kërkesës së Ankuesit dhe projekti ishte regjistruar në favor të saj.

Si ka mundësi të regjistrohet projekti të prodhuesit VISSONIC me 18.06.2026 kur komunikimi me VISSONIC ka ndodhur me datën 23.06.2026 në ora 9:43 dhe përgjigjeja e prodhuesit VISSONIC ishte: projekti është rezervuar për 5 ditë që i bie me datën 18.06.2026. Me datën 18.06.2026 Autoriteti Kontraktues kishte ngarkuar komplet një dosje tjetër të tenderit me titull “Dislokimi i rrjetit” gjë e mund të vërtetohet në e-prokurim ky fakt?!!!

3. Në tender është shpallur fitues pikërisht grupi IMPACT + CIMI@ELECTRONIC

Dokumentacioni i tenderit tregon se grupi fitues përbëhet nga:

- IMPACT SH.P.K. – Dega në Kosovë;
- CIMI@ELECTRONIC SHPK.

IMPACT është lider me 80%, ndërsa CIMI@ELECTRONIC ka 20%.

Pra ekziston kjo sekuencë faktike:

Informacion për regjistrim paraprak → shqetësim i dokumentuar për rezultatit → kërkesë për MAF e lidhur me projektin → kufizim i Ankuesit për të siguruar MAF → shpallja fituese e grupit IMPACT + CIMI.

Kjo sekuencë nuk provon vetvetiu manipulimin.

Por është më se e mjaftueshme për të kërkuar verifikim të dokumentuar dhe të pavarur.

KËRKESA PËR HETIM TË REGJISTRIMIT TË PROJEKTIT TË VISSONIC

Kërkojmë nga OSHP-ja që, përmes kompetencave të saj, të kërkojë nga AK-ja dhe/ose të administrojë si provë:

1. Datën kur është regjistruar projekti të VISSONIC;
2. Identitetin e subjektit që e ka regjistruar projektin;
3. Datën kur është kërkuar oferta;
4. Datën kur është kërkuar MAF;
5. Identitetin e personit/subjektit që ka bërë kërkesën;
6. Dokumentacionin e komunikimit ndërmjet VISSONIC dhe subjektit përkatës;
7. Datën e lëshimit të MAF-it;

8. Përmbajtjen e MAF-it;
9. Produktet që janë përfshirë në MAF;
10. Nëse MAF-i i lëshuar për grupin fitues përputhet me të gjitha produktet e kërkuara nga DT.

Kjo është çështje faktike dhe mund të verifikohet me dokumente.

KRONOLOGJIA E DOSJES SË TENDERIT DHE DATA 23.06.2026 KËRKOJNË VERIFIKIM TË DOKUMENTUAR

Një nga çështjet më serioze që kërkojmë të verifikohet lidhet me kronologjinë e dokumentacionit të publikuar në e-Prokurim.

Sipas dokumenteve të paraqitura nga Ankuesi:

1. më 18.06.2026 është publikuar aktiviteti i prokurimit;
2. dokumentacioni i publikuar në fazën fillestare, sipas materialeve në dispozicion, përmbante dokumentacion të një aktiviteti tjetër me titull **“DISLOKIMI I RRJETIT”**;
3. më 23.06.2026 figuron formular për korrigjimin e gabimeve;
4. dokumentacioni përfundimtar është ndryshuar ose korrigjuar gjatë procedurës;
5. MAF-i i paraqitur nga operatori fitues mban datën **23.06.2026**.
6. OE e cila paraqet komunikimin me prodhuesin se MAF dhe projekti janë rezervuar para dates 18.06.2026 kur dosja e tenderit ne faqen e-prokurim ishte “Dislokimi i rrjetit”

Për këtë arsye kërkojmë verifikimin e plotë të historikut elektronik të e-Prokurimit, përfshirë:

- versionin fillestar të Dosjes së Tenderit;
- datën dhe orën e publikimit;
- dokumentet e publikuara fillimisht;
- çdo korrigjim ose zëvendësim;
- datën dhe orën e ndryshimeve;
- historikun elektronik të aktivitetit;
- dhe, nëse është teknikisht e mundur, përdoruesin që ka kryer ndryshimet.

Çështja qendrore është:

Nëse dokumentacioni teknik përfundimtar për sistemin e sallës së kuvendit është bërë i disponueshëm ose është korrigjuar më 23.06.2026, mbi çfarë dokumentacioni teknik konkret është kërkuar dhe lëshuar MAF-i me të njëjtën datë?

Kjo pyetje nuk kërkon supozime. Ajo mund dhe duhet të verifikohet përmes dokumenteve dhe log-

eve elektronike.

REGJISTRIMI PARAPRAK I PROJEKTIT TE VISSONIC DHE AVANTAZHI I MUNDSHËM PARAPRAK

OE e interesuar per pjesmarrje ne tender ka komunikuar drejtpërdrejt me prodhuesin VISSONIC në përpjekje për të siguruar MAF.

Nga komunikimi i paraqitur rezulton se prodhuesi ka deklaruar, ndër të tjera:

“when they come to us with a project information in advance than others, we will check and make it registered to protect them...”

dhe:

“Very sorry that the project you mentioned in this email was registered by another company who asked for offer and MAF 5 days ago.”

Kjo rrethanë është veçanërisht e rëndësishme sepse tregon ekzistimin e një mekanizmi të regjistrimit ose mbrojtjes së projektit.

OE me këtë rast nuk kërkon që OSHP-ja të konstatojë automatikisht se kjo përbën manipulim të tenderit.

Përkundrazi, kërkojmë që faktet të verifikohen drejtpërdrejt.

Veçanërisht kërkojmë të verifikohet:

1. data e parë kur projekti është paraqitur te VISSONIC;
2. data e regjistrimit të projektit;
3. identiteti i subjektit që e ka regjistruar;
4. data e kërkesës për ofertë;
5. data e kërkesës për MAF;
6. identiteti i subjektit që ka bërë kërkesën;
7. data e lëshimit të MAF-it;
8. përmbajtja e MAF-it;
9. produktet që janë përfshirë në MAF;
10. dokumenti teknik i parë që i është dërguar prodhuesit;
11. komunikimi i plotë relevant ndërmjet VISSONIC dhe subjektit përkatës.

Nëse rezulton se projekti është regjistruar para publikimit të tenderit ose para momentit kur dokumentacioni teknik i projektit është bërë publikisht i disponueshëm, atëherë duhet të verifikohet se nga është marrë informacioni për projektin dhe nëse ky informacion ka qenë në dispozicion të

barabartë për operatorët e tjerë ekonomikë.

SEKUENCA FAKTIKE KËRKON VERIFIKIM INSTITUCIONAL

Në këtë procedurë ekzistojnë disa rrethana që duhet të analizohen së bashku:

- dokumentacioni fillestar i publikuar dyshohet se ka përmbajtur dokumentacion të një projekti tjetër;
- dokumentacioni është korrigjuar ose ndryshuar;
- MAF-i i operatorit fitues mban datën 23.06.2026;
- VISSONIC ka deklaruar se projekti ishte regjistruar nga IMPACT SH.P.K& CIMI@ELECTRONIC para 5 dite ky komunikim ka ndodhur me 23.06.2026 me VISSONIC që I bie me 18.06.2026 projekti është regjistruar kur dosja e tenderit në e-prokurim ishte me titull: “Dislokimi i rrjetit”;
- Ankuesi ka hasur pengesë për sigurimin e MAF-it për shkak të regjistrimit të projektit;
- MAF-i ishte dokument me rëndësi për pranueshmërinë;
- shqetësimi i Ankuesit lidhur me këtë çështje ishte ngritur dhe dokumentuar para përfundimit të procedurës;
- në fund të procedurës fitues është shpallur grupi IMPACT SH.P.K. – Dega në Kosovë + CIMI@ELECTRONIC SHPK.

Asnjëra nga këto rrethana, e marrë më vete, nuk duhet automatikisht të trajtohet si provë e manipulimit.

Por të gjitha së bashku krijojnë një bazë objektive dhe të dokumentueshme që kërkon verifikim të pavarur institucional.

KËRKESA PËR MAF DHE PRODUKTET E GRUPIT FITUES

Dosja e Tenderit kërkon autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për produktet përkatëse të sistemit të zërit dhe konferencave.

Në kërkesën tonë kemi identifikuar produkte konkrete për të cilat, bazuar në dokumentacionin që kemi shqyrtuar, nuk kemi gjetur MAF/autorizim përkatës.

Në veçanti janë ngritur pretendime lidhur me:

- **Pozicioni 11 – LD System / VIBZ 8 / LDVIBZ8DC;**

- **Pozicioni 13 – TOA / Mixer Power Amplifiers A-2000 Series;**
- **Pozicioni 14 – TOA / Public Address Speakers PC/BS/PE/PJ Series;**
- **Pozicioni 15 – Hisense H5 Series Full HD Smart TV;**
- si dhe pozicione të tjera të ofertës.

Në kërkesën e rishqyrtimit është evidentuar se për disa prej këtyre produkteve nuk është paraqitur MAF/autorizim, megjithëse kërkesa e DT-së ka qenë për autorizim për produktet e ofruara.

Kjo nuk kërkon interpretim të komplikuar juridik.

Për këtë arsye kërkojmë që eksperti shqyrtues të bëjë verifikim individual për secilin produkt, përmes një table krahasuese:

Pozicioni	Prodhuesi	Modeli	A kërkohej MAF/autorizim?	Dokumenti i dorëzuar	A mbulon produktin konkret?	Përputhja
-----------	-----------	--------	---------------------------	----------------------	-----------------------------	-----------

dhe ta verifikojë çdo produkt.

Ky verifikim duhet të bëhet mbi dokumentacionin origjinal të ofertës fituese dhe kërkesat konkrete të Dosjes së Tenderit.

Nëse për një produkt për të cilin DT-ja ka kërkuar autorizim nuk ekziston dokumenti përkatës ose dokumenti nuk mbulon produktin konkret të ofruar, kjo duhet të vlerësohet në përputhje me kërkesat e procedurës.

POZICIONI NR. 15 – NEVOJA PËR VERIFIKIM TË DOKUMENTACIONIT TEKNIK

Për pozicionin 15, Ankuesi ka pretenduar se grupi fitues nuk ka paraqitur specifikime teknike, katalog, broshurë ose dokumentacion tjetër të mjaftueshëm për produktin e kërkuar që mundëson verifikimin e përputhshmërisë së produktit me specifikimet e kërkuara.

Kjo çështje nuk është një pretendim i përgjithshëm për mënyrën se si është hartuar DT-ja.

Është pretendim konkret për përmbajtjen e ofertës së grupit fitues.

Prandaj nuk mund të konsiderohet “res judicata”.

Kërkojmë që eksperti i OSHP-së të kontrollojë drejtpërdrejt ofertën e grupit fitues dhe të konstatojë nëse për pozicionin 15 ekziston dokumentacioni teknik i kërkuar.:

- katalogun;
- datasheet-in;
- broshurën;
- specifikimet teknike;

- dhe çdo dokument tjetër të dorëzuar për këtë produkt.

Duhet të konstatohet qartë nëse dokumentacioni i paraqitur ekziston dhe nëse ai dëshmon përputhshmërinë e produktit konkret me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

XV. SIGURIMI I TENDERIT TË GRUPIT FITUES

Në kërkesën për rishqyrtim kemi ngritur gjithashtu çështjen e sigurimit të tenderit.

Oferta është dorëzuar nga grupi:

IMPACT + CIMI@ELECTRONIC

ndërsa sigurimi i tenderit është lëshuar në emër të:

IMPACT SH.P.K. – Dega në Kosovë.

Nëse marrëveshja e grupit përcakton përgjegjësi të përbashkët dhe individuale të anëtarëve, duhet të verifikohet nëse sigurimi i dorëzuar mbulon juridikisht detyrimet dhe përgjegjësinë e grupit si tërësi.

Rregullorja Nr. 001/2022 e trajton sigurimin e tenderit si garanci për respektimin e detyrimeve të tenderuesit dhe përcakton se, kur ai kërkohet nga AK-ja, zbatohet për tenderuesit sipas kushteve të DT-së.

Për këtë arsye kërkojmë verifikim të:

- emrit të përfituesit;
- emrit të tenderuesit;
- anëtarëve të grupit;
- shumës;
- afatit;
- kushteve të garancisë;
- dhe mbulimit të detyrimeve të të gjithë grupit.

Qëllimi i këtij pretendimi nuk është të krijohen interpretime formale, por të verifikohet nëse dokumenti i paraqitur i plotëson kërkesat që AK-ja i ka vendosur për tenderuesin konkret.

KËRKESAT PËR STAF, CERTIFIKIME DHE ISO - EFEKTI KUMULATIV NË KONKURRENCË

Ankuesi nuk pretendon se AK-ja nuk ka të drejtë të kërkojë staf të kualifikuar apo certifikime relevante. Ankuesi ka argumentuar se DT-ja ka krijuar një kombinim jashtëzakonisht specifik të kërkesave për staf dhe certifikime.

Çështja është nëse kombinimi konkret i kërkesave ka qenë:

- objektivisht i nevojshëm;

- proporcional;
- i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës;
- dhe i tillë që nuk kufizon pa arsye konkurrencën.

Në Dosjen e Tenderit janë kërkuar, ndër të tjera:

- inxhinier elektroteknik me përvojë dhe certifikim në programim;
- inxhinier ose master i shkencave kompjuterike me Licencë A;
- inxhinier elektroteknik me certifikim për siguri dhe shëndet në punë;
- teknik elektroteknik me kompetenca ose certifikime në IT, LAN Architecture dhe Lead Auditor;
- teknik me certifikatë SIMZ;
- teknikë të certifikuar nga prodhuesit për Sound System dhe Conference System;
- person i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë.

Po ashtu janë kërkuar një numër standardesh ISO, përfshirë:

- ISO 9001;
- ISO 14001;
- ISO 20000-1;
- ISO 50001;
- ISO 27001;
- ISO 45001.

Çështja nuk është nëse AK-ja mund të kërkojë staf të kualifikuar apo standarde ISO.

Çështja është:

A ekziston një nevojë objektive, proporcionale dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës për këtë kombinim të veçantë të kërkesave?

Veçanërisht duhet të arsyetohet pse një teknik i vetëm duhet të ketë njëkohësisht kompetenca në:

IT + LAN Architecture + Lead Auditor + elektroteknikë.

Po ashtu duhet të arsyetohet pse kompetenca e inxhinierit elektroteknik duhet të kombinohet me certifikimin për siguri dhe shëndet në punë.

Këto kërkesa, të marra së bashku, mund të krijojnë një profil jashtëzakonisht të ngushtë të operatorit ekonomik.

LIDHJA NDËRMJET KRITEREVE KUFIZUESE DHE AVANTAZHIT TË MUNDSHËM TË

OPERATORIT TË ÇAKTUAR

Në mënyrë të veçuar, secila kërkesë mund të duket e arsyeshme.

Por duhet të analizohet **efekti kumulativ**.

Në këtë procedurë kemi një kombinim të:

- kërkesave shumë specifike për staf;
- shumë certifikimeve;
- shumë ISO-ve;
- kërkesës për MAF;
- kërkesave të detajuara teknike;
- dhe regjistrimit paraprak të projektit të prodhuesi.

AK-ja duhet të jetë në gjendje të arsyetojë pse secila kërkesë është e domosdoshme për realizimin e kontratës dhe pse kombinimi i tyre nuk krijon një profil të panevojshëm dhe jashtëzakonisht të ngushtë të operatorëve ekonomikë që mund të marrin pjesë.

Kur këto kërkesa analizohen së bashku me:

- kërkesën për MAF;
- mekanizmin e mundshëm të “project registration”;
- specifikimet teknike shumë të detajuara;
- dhe rrethanat e kronologjisë së tenderit,

atëherë duhet të vlerësohet ndikimi i përgjithshëm i tyre në konkurrencë.

Kur këto rrethana analizohen së bashku, krijohet nevoja për të verifikuar nëse procedura ka prodhuar një konkurrencë reale apo nëse ka krijuar avantazh të veçantë për një operator ose grup të caktuar.

Kjo është pikërisht arsyeja pse nuk mjafton një shqyrtim formal i dokumenteve.

PËR AKUZËN E AK-së SE ANKUESI KA VEPRUAR “TENDENCIOZISHT”

AK-ja ka përdorur në vendimin e saj një formulim jashtëzakonisht të rëndë duke e karakterizuar veprimin e Ankuesit si tendencioz dhe me qëllim të pengimit të aktivitetit të prokurimit.

Ky konstatim është i papranueshëm në mungesë të një analize faktike dhe juridike që e provon një qëllim të tillë.

Ankuesi ka ushtruar një të drejtë të garantuar nga mekanizmi i shqyrtimit të prokurimit.

Për më tepër, Ankuesi nuk ka ngritur vetëm pretendime pas shpalljes së fituesit.

Përkundrazi, shqetësimi lidhur me regjistrimin paraprak të projektit është dokumentuar që më 25.06.2026, pra para përfundimit të procedurës.

Prandaj është juridikisht dhe faktikisht e pasaktë që një shqetësim i dokumentuar para shpalljes së fituesit të karakterizohet më pas si një veprim i krijuar vetëm për të penguar procedurën.

Nëse AK-ja pretendon se Ankuesi ka vepruar me qëllim tendencioz, atëherë duhet të paraqesë:

- cilin veprim konkret e konsideron abuziv;
- cilën dispozitë konkrete e ka shkelur Ankuesi;
- cilat prova e mbështesin këtë konstatim;
- dhe si lidhet ky konstatim me secilin pretendim të ngritur.

Në mungesë të këtyre elementeve, ky formulim mbetet një deklaram i pambështetur.

Ky konstatim nuk mund të zëvendësojë shqyrtimin e pretendimeve konkrete.

Ankuesi ka:

- analizuar Dosjen e Tenderit;
- kërkuar sqarime;
- komunikuar me prodhuesin;
- identifikuar çështje konkrete;
- përdorur mekanizmin e kërkesës për rishqyrtim;
- dhe tani ushtron të drejtën ligjore për ankesë.

Veçanërisht e rëndësishme është se shqetësimi lidhur me regjistrimin paraprak të projektit nuk është krijuar pas shpalljes së fituesit.

Ai është ngritur dhe dokumentuar gjatë procedurës.

Nëse AK-ja pretendon ekzistimin e një qëllimi abuziv ose tendencioz, një konstatim i tillë duhet të mbështetet në:

- veprimin konkret që konsiderohet abuziv;
- dispozitën e shkelur;
- provat që mbështesin këtë pretendim;
- dhe lidhjen e këtij pretendimi me faktet konkrete të rastit.

Në mungesë të një arsytimi të tillë, etiketime të përgjithshme nuk mund të zëvendësojnë detyrimin për shqyrtim objektiv të pretendimeve.

DYSHIMI PËR FAVORITIZIM DHE NEVOJA PËR VERIFIKIM INSTITUCIONAL

Ankuesi e konsideron veçanërisht shqetësuese përputhjen ndërmjet:

1. informacionit të marrë nga VISSONIC për regjistrimin paraprak të projektit;
2. faktit se një subjekt kishte kërkuar ofertë dhe MAF para Ankuesit;
3. faktit se Ankuesi e kishte dokumentuar shqetësimin para përfundimit të procedurës;
4. faktit se pas përfundimit të procedurës fitues doli grupi IMPACT + CIMI@ELECTRONIC;
5. faktit se MAF-i ishte bërë kriter i rëndësishëm për pranueshmërinë e ofertës.

Këto rrethana nuk duhet të shpallen automatikisht si provë e manipulimit.

Por ato përbëjnë **indicie të mjaftueshme për një verifikim objektiv dhe të dokumentuar.**

Nëse verifikimi tregon se një operator kishte siguruar paraprakisht qasje, MAF ose avantazh të veçantë për projektin, ndërsa dokumentacioni i tenderit e bënte këtë MAF vendimtar për pranueshmërinë, atëherë **duhet të vlerësohet nëse është cenuar parimi i konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë.**

KËRKESA PËR VERIFIKIM TË KONFLIKTIT TË INTERESIT DHE TË RRETHANAVE TË HARTIMIT TË DT-së

Duke pasur parasysh rrethanat e mësipërme, kërkojmë që OSHP-ja të verifikojë edhe:

1. Kush ka marrë pjesë në hartimin e specifikimeve teknike;
2. Kush ka propozuar kriteret teknike;
3. Kush ka propozuar kriteret për staf dhe certifikime;
4. Kush ka propozuar kërkesat për ISO;
5. Kush ka përcaktuar kërkesën për MAF;
6. Nëse janë kryer analiza të tregut para përcaktimit të këtyre kriterëve;
7. Nëse AK ka pasur kontakte me operatorë ekonomikë ose prodhues para publikimit të DT-së në lidhje me këtë projekt;
8. Nëse ndonjë person i përfshirë në përgatitjen e DT-së ka pasur marrëdhënie, interes ose komunikim të veçantë me operatorin fitues ose me prodhuesin përkatës;
9. Nëse ekzistojnë rrethana që mund të përbëjnë konflikt interesi apo ndikim të papërshtatshëm në procedurë.

Këto kërkesa nuk nënkuptojnë se Ankuesi po deklaron se një person i caktuar ka kryer shkelje penale.

Kërkohet **verifikim institucional i fakteve.**

ÇËSHËTJA NUK MUND TË REDUKTOHET VETËM NË STATUSIN E OFERTËS SË ANKUESIT

Ankuesi nuk e mohon faktin se oferta e saj është konsideruar e papërgjegjshme, përfshirë çështjen e sigurimit të tenderit.

Megjithatë, Ankuesi ka shpjeguar se kjo çështje është lidhur edhe me paqartësitë dhe mospërputhjet e pretenduara në dokumentacion lidhur me afatet përkatëse.

Por edhe përtej kësaj çështjeje, thelbi i ankesës është më i gjerë.

Pyetja që kërkon përgjigje është:

A është zhvilluar kjo procedurë në përputhje me parimet e konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë, transparencës dhe proporcionalitetit, dhe a e ka përmbushur oferta fituese çdo kërkesë të vendosur nga vetë AK-ja?

Nëse verifikimi institucional konstaton se gjithçka është zhvilluar në mënyrë të rregullt dhe oferta fituese i plotëson të gjitha kërkesat, atëherë ky rezultat duhet të mbështetet në verifikim objektiv.

Por nëse verifikimi konstaton se:

- projekti është regjistruar paraprakisht në mënyrë që ka krijuar avantazh ekskluziv;
- informacioni teknik është siguruar nga burime që nuk kanë qenë në dispozicion të barabartë për operatorët;
- MAF-i nuk mbulon të gjitha produktet;
- oferta fituese nuk ka dokumentacion teknik të mjaftueshëm;
- sigurimi i tenderit nuk mbulon tenderuesin si grup;
- ose kërkesat e procedurës kanë cenuar konkurrencën në mënyrë strukturore,

atëherë këto çështje kërkojnë zbatim të masave përkatëse juridike.

PSE NUK MJAFTON RIVLERËSIMI I OFERTAVE

Nëse OSHP-ja konstaton vetëm probleme me ofertën e grupit fitues, mund të jetë e mjaftueshme kthimi në rivlerësim.

Por në rastin konkret ekzistojnë pretendime që lidhen me vetë kushtet në të cilat është krijuar konkurrenca.

Në kërkesën e rishqyrtimit është argumentuar se:

- kriteret e stafit janë të ngushta;
- ISO-të janë të shumta;
- certifikimet janë të kombinuara në mënyrë specifike;
- MAF-i është bërë element i rëndësishëm;

- projekti është regjistruar paraprakisht sipas komunikimit të prodhuesit;
- Ankuesi e ka evidentuar këtë para përfundimit të procedurës;
- dhe grupi i lidhur me këtë informacion është shpallur fitues.

Nëse këto rrethana verifikohen dhe rezultojnë të sakta, vetëm rivlerësimi i ofertave nuk do ta rikthente konkurrencën.

Operatorët që janë penguar të marrin pjesë për shkak të kriterëve të tenderit nuk mund të hyjnë në procedurë pasi ajo tashmë ka përfunduar.

Për këtë arsye, nëse OSHP-ja konstaton se shkeljet kanë qenë strukturore dhe kanë cenuar konkurrencën, masa proporcionale është **anulimi i aktivitetit dhe ritenderimi me DT të korrigjuar**

KËRKESAT KONKRETE DREJTUAR OSHP-së

Për të gjitha arsyet e lartcekura, kërkojmë nga OSHP-ja:

1. Të aprovojë ankesën e SMART MODEL L.L.C. si të bazuar.
2. Të anulojë Vendimin e Autoritetit Kontraktues nr. 640/26, datë 24.08.2026.
3. Të konstatojë se AK-ja nuk ka dhënë përgjigje të plotë, konkrete dhe të arsyetuar ndaj pretendimeve kryesore të Ankuesit.
4. Të konstatojë se AK-ja nuk ka mundur ta mbyllë shqyrtimin e pretendimeve konkrete për ofertën fituese vetëm duke iu referuar statusit të ofertës së Ankuesit.
5. Të urdhërojë verifikimin e plotë të ofertës së grupit IMPACT + CIMI@ELECTRONIC.
6. Të urdhërojë verifikimin individual të MAF-it/autorizimit për çdo produkt për të cilin DT-ja e ka kërkuar atë.
7. Të verifikojë mungesën e pretenduar të MAF-it për pozicionet 11, 13, 14, 16, 17, 18, 19 dhe pozicionet tjera të identifikuar.
8. Të verifikojë dokumentacionin teknik të pozicionit 15 dhe nëse oferta fituese ka përmbushur kërkesat e DT-së për këtë pozicion.
9. Të verifikojë vlefshmërinë, përmbajtjen, shumën, periudhën dhe shtrirjen juridike të sigurimit të tenderit të grupit IMPACT + CIMI@ELECTRONIC.
10. Të verifikojë datën dhe subjektin që ka regjistruar projektin te VISSONIC.
11. Të verifikojë datën kur është kërkuar oferta dhe MAF-i nga subjekti që e ka regjistruar projektin.
12. Të verifikojë nëse grupi IMPACT + CIMI@ELECTRONIC ose ndonjë anëtar i tij ka pasur qasje paraprake në projekt, MAF ose informacione të tjera të lidhura me tenderin.
13. Të verifikojë nëse kërkesat për staf, certifikime dhe ISO janë objektive, proporcionale dhe të

lidhura me nevojat reale të kontratës.

14. Të verifikojë nëse specifikimet teknike kanë qenë të hartuara mbi bazën e nevojave funksionale të Autoritetit Kontraktues apo kanë pasur efektin e përshtatjes me produkte/prodhues të caktuar.
15. Të verifikojë nëse ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit ose ndonjë ndërhyrje që mund të ketë cenuar paanshmërinë e procedurës.
16. Nëse konstatohen shkelje që kanë ndikuar në rezultat ose në konkurrencë, të anulojë Vendimin për Dhënie të Kontratës dhe të urdhërojë masën përkatëse sipas kompetencave të OSHP-së.
17. Nëse konstatohet se shkeljet kanë qenë strukturore dhe kanë cenuar konkurrencën që nga hartimi i DT-së, të anulohet i gjithë aktiviteti i prokurimit nr. 644-26-4808-1-2-1 dhe të urdhërohet ritenderimi nga fillimi me dokumentacion të ri, objektiv, proporcional dhe jodiskriminues.
18. Të urdhërohet që, në rast të ritenderimit, kriteret për staf, ISO, MAF dhe specifikimet teknike të rishikohen në mënyrë që të sigurohet konkurrencë reale dhe trajtim i barabartë.
19. Nëse gjatë shqyrtimit OSHP-ja konstaton elemente që tejkalojnë kompetencën e saj dhe krijojnë dyshime për konflikt interesi, favorizim, ndërhyrje të palejuar ose veprime të tjera të kundërligjshme, të ndërmerren veprimet institucionale përkatëse dhe, sipas kompetencës ligjore, çështja t'u përcillet organeve kompetente për verifikim të mëtejshëm.

KËRKESË PËR MASË TË PËRKOHSHME / PEZULLIM TË PROCEDURËS

Duke pasur parasysh se Vendimi i AK-së është i datës 24.08.2026 dhe se procedura është në vazhdim, kërkojmë që OSHP-ja të marrë parasysh nevojën për pezullimin e procedurës deri në përfundimin e shqyrtimit të kësaj ankese.

Kjo kërkesë është veçanërisht e arsyeshme për shkak se, nëse kontrata nënshkruhet dhe procedura përfundon, korrigjimi i mëvonshëm i shkeljeve mund të bëhet shumë më i vështirë dhe mund të krijojë pasoja që nuk mund të riparohen në mënyrë efektive.

KËRKESAT KONKRETE DREJTUAR OSHP-së

Për të gjitha arsyet e lartcekura, ANKUESI kërkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që:

1. **Ta aprovojë ankesën e SMART MODEL L.L.C. si të bazuar, në masën në të cilën konstatohen shkeljet e pretenduara.**
2. **Ta anulojë Vendimin e Autoritetit Kontraktues nr. 640/26, datë 24.08.2026.**
3. **Të konstatojë se AK-ja nuk ka dhënë përgjigje të plotë, individuale dhe të arsyetuar ndaj pretendimeve konkrete të paraqitura nga Ankuesi.**
4. **Të konstatojë se pretendimet lidhur me ofertën fituese dhe faktet e reja nuk mund të**

përfashtohen automatikisht vetëm duke iu referuar statusit të ofertës së Ankuesit ose konceptit të “res judicata”.

5. Të urdhërojnë verifikimin e plotë të ofertës së grupit IMPACT SH.P.K. – Dega në Kosovë + CIMI@ELECTRONIC SHPK.
6. Të urdhërojnë verifikimin individual të MAF-it ose autorizimit për secilin produkt për të cilin Dosja e Tenderit ka kërkuar një dokument të tillë.
7. Të verifikojë dokumentacionin teknik për pozicionin nr. 15 dhe çdo pozicion tjetër të kontestuar për të cilin ekziston pretendim konkret për mungesë të provës së përputhshmërisë.
8. Të verifikojë vlefshmërinë dhe shtrirjen juridike të sigurimit të tenderit të dorëzuar nga grupi fitues.
9. Të kërkojë dhe verifikojë historikun elektronik të Dosjes së Tenderit dhe ndryshimet e bëra në e-Prokurim, përfshirë datën dhe kohën e korrigjimeve.
10. Të kërkojë verifikim të drejtpërdrejtë lidhur me regjistrimin e projektit të VISSONIC, datën e kërkesës për ofertë dhe MAF, identitetin e subjektit kërkuar dhe dokumentacionin teknik të përdorur.
11. Të shqyrtojë nëse rrethanat e regjistrimit paraprak të projektit, në kombinim me kërkesën për MAF, kanë krijuar një avantazh të mundshëm që ka cenuar konkurrencën e barabartë.
12. Të shqyrtojë proporcionalitetin dhe efektin kumulativ të kërkesave për staf, certifikime dhe ISO në konkurrencën reale.
13. Nëse konstatohen shkelje strukturore që kanë cenuar konkurrencën, transparencën ose trajtimin e barabartë dhe që nuk mund të korrigjohen përmes rivlerësimit, të anulohet aktiviteti i prokurimit dhe të urdhërohet zhvillimi i një procedure të re me dokumentacion të qartë, proporcional dhe jodiskriminues.

Kjo ankesë nuk është thjesht një kundërshtim ndaj rezultatit të tenderit.

Çështja që i paraqitet OSHP-së është nëse:

A është zhvilluar kjo procedurë në kushte reale të konkurrencës, transparencës dhe trajtimit të barabartë, apo nëse një kombinim i kërkesave të ngushta, mekanizmit të MAF-it dhe rrethanave të regjistrimit paraprak të projektit ka krijuar avantazh të padrejtë për një operator/grup të caktuar.

Ne nuk kërkojmë që OSHP-ja të marrë paraprakisht një konkluzion se tenderi është manipuluar.

Kërkojmë diçka më konkrete dhe më të rëndësishme:

TË VERIFIKOHEN FAKTET.

Nëse faktet konfirmojnë se një operator kishte siguruar paraprakisht avantazh në lidhje me projektin dhe MAF-in, ndërsa kriteret e tenderit e bënin këtë dokument vendimtar për pjesëmarrjen dhe pranueshmërinë, atëherë duhet të vlerësohet seriozisht nëse është cenuar konkurrenca e barabartë.

Nëse, për më tepër, konstatohet se grupi fitues nuk ka përmbushur kërkesat e DT-së për MAF, dokumentacion teknik apo sigurim të tenderit, atëherë rezultati i procedurës nuk mund të mbrohet vetëm me arsyetimin se Ankuesi vetë është konsideruar i papërgjegjshëm.

Ligjshmëria e ofertës fituese dhe ligjshmëria e procedurës janë çështje që duhet të shqyrtohen në mënyrë të pavarur.

Në këtë rast ekzistojnë rrethana të mjaftueshme për një shqyrtim të thelluar.

Për këtë arsye kërkojmë nga OSHP-ja që:

Ta aprovojë ankesën, ta anulojë Vendimin nr. 640/26, të urdhërojë verifikimin e plotë të ofertës fituese dhe, nëse konstatohen shkelje që kanë cenuar konkurrencën në mënyrë strukturore, ta anulojë aktivitetin e prokurimit dhe të urdhërojë ritenderimin nga fillimi.

8. Dëmet materiale

Përkthej mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Mosrespektimi i dispozitave të LPP-së i shkakton operatorit ekonomik:

- pamundësi reale për pjesëmarrje në procedurë;
- humbje të mundësisë për konkurrim të barabartë;
- dëmtim ekonomik dhe reputacional;
- cenim të besimit të operatorëve ekonomikë në sistemin e prokurimit publik.

Ne si OE kemi shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit, ofertave dhe pjesëve tjera të cilat ndërlidhet me këtë procedurë të prokurimit, shpenzimet për sigurimin e Ofertes, Shpenzimet e Avokatisë si në përgatitjen e kërkesave për rishqyrtim ashtu edhe për përgatitjen e ankesës.

Dëmi refletkon në dëmin material dhe jo material e i cili shtrihet edhe në raport me LMD neni 136, 137 duke mos u kufizuar edhe edhe në dëmtimin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.
- I....T&C...@E.....C

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.